



UNMIK



IPVK

**INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT**

**QEVERIA E KOSOVËS/ MINISTERIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
VLADA KOSOVA/ MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
GOVERNMENT OF KOSOVA/MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL
DEVELOPMENT**

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 01/2004

Për caktimin e kushteve për licencimin e importuesve të pesticideve, për tregtimin dhe deponimin e pesticideve

Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, duke u bazuar në:

Rregullorën e UNMIK-ut nr.2001/9 të datës 15 maj 2001 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, neni 5.1 pika (n), Rregullorën e UNMIK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, neni 1.3 pika (d) dhe Ligjit për Pesticidet Nr. 2003/20 të datës 8 dhjetor 2003, neni 19.1 pika (e) dhe (f),

Nxjerr sa vijon:

Neni 1.

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen kushtet për licencimin e importuesve të pesticideve, për tregtimin me pesticide dhe për deponimin e tyre.

Neni 2.

Personat të cilët merren me tregtimin e pesticideve duhet të licencohen nga Departamenti për Prodhimtari dhe Mbrojtje të Bimëve të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Personi që licençohet si importues dhe tregtues i pesticideve duhet t'i plotësojë kushtet e veçanta siç janë:

- të posedojë kualifikim përkatës profesional dhe
- të kenë të punësuar personat që e i plotësojnë kushtet lidhur me kualifikimin përkatës konform nenit 8 pika 3 të Ligjit për Pesticidet.

Neni 3.

Shitjen e pesticideve në barnatoret bujqësore mund ta bëjnë vetëm personat të cilët e posedojnë të pakten pregaditjen e mesme profesionale ose personat që me anë të trajnimit dhe kurseve shtesë janë aftësuar për tu marrur me tregtimin e pesticideve dhe për të punuar në barnatoren bujqësore.

Për trajnimin dhe dëshmitë shtesë se janë aftësuar për tregtim të pesticideve duhet ta posedojnë dëshminë përkatëse.

Neni 4.

Përsonat të cilët dëshirojnë të licençohen si importues dhe tregtues të pesticideve duhet të aplikojnë në Departamentin për Prodhimtari dhe Mbrojtje të Bimëve të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me ç'rast aplikacionit duhet t'ia bashkëngjesin edhe çertifikatën mbi regjistrimin e biznesit të lëshuar nga organi kompetent për regjistrim.

Neni 5.

Aplikacionin për regjistrim, Departamenti për Prodhimtari dhe Mbrojtje të Bimëve i MBPZHR do ta shqyrtojë në afatin prej tetë (8) ditësh nga dita e aplikimit me ç'rast do t'i verifikojë edhe të dhënat tjera të nevojshme para sa te vendosë për licencim.

Neni 6.

Ministria do të formoi Komisionin e posaçëm për dhënien e licencës në të cilin duhet të jenë kuadri profesionist – Drejtori i Departamentit, Personi Zyrtar për Pesticide, përfaqësuesi i Shërbimit Juridik dhe Inspektori Fitosanitar, nga rajoni i paraqitësit të kërkesës.

Para se Komisioni të vendosë për dhënien e licencës duhet ta marrë raportin nga Inspektori Fitosanitar i Rajonit, të cilin e harton me rastin e kontrollit të objektit – lokalit afarist (barnatores bujqësore) në të cilin do të bëhet tregtimi i pesticideve.

Neni 7.

Në rast se janë plotësuar të gjitha kushtet sipas Ligjit për Pesticidet dhe sipas këtij Udhëzimi Administrativ për dhënie të licencës, Komisioni lëshon licencën – çertifikatën aplikuesit në formë të shkruar.

Në rast se nga Komisioni konstatohet se aplikuesi nuk i ka plotësuar kushtet për licencim, atëherë të njëjtit i lejohej afati prej tri (3) ditësh për kompletimin e aplikacionit.

Në rast se aplikuesi nuk arrinë që ta bëjë kompletimin e aplikacionit në afatin shtesë aplikacioni refuzohet.

Neni 8.

Pas marrjes së licencës personi i licencuar mund të tregtojë vetëm pesticidet të cilat janë të lejuara për tregtim me Udhëzimin Administrativ Nr. 11/2003 të dt. 24.12.2003, respektivisht me Udhëzimet Administrative të tjera, që mund të nxirren për ndryshimin dhe plotësimin e regjistrit të pesticideve të lejuara për tregtim.

Neni 9.

Personi i licencuar për tregtim të pesticideve është i obliguar që licencën ta vendosë në vend të dukshëm në lokalin për tregtim të pesticideve.

Neni 10.

Çdo objekt – lokal për tregtim të pesticideve, përveç kushteve teknike ndërtimore të cilat i përcakton organi i autorizuar komunal duhet t'i plotësojë edhe kushtet shtesë:

- të jetë i ndërtuar në vende me dendësi më të vogël të njerëzve dhe kafshëve,
- larg ujërave rrjedhës,
- larg fabrikave për prodhimin dhe përpunimin e ushqimit dhe
- larg enteve edukativo - arsimore.

Përveç kushteve nga paragrafi 1 i këtij neni, objekti – lokali në të cilin bëhet tregtimi dhe deponimi i pesticideve duhet të jetë i siguar (rrethuar) edhe në formë tjetër (rreth objektit ku gjenden të vendosura pesticidet hapet kanal në të cilin do të pamundësohej shpërndarja e pesticideve në rastet kur ato mund të rrjedhin) dhe se objekti i tillë duhet të jetë i paisur me shenja paralajmëruese të cilat tregojnë “RREZIK NGA HELMET”. Poashtu objektet e tilla duhet të jenë të paisura me mjete teknike dhe sanitare mbrojtëse në punë, aparatën për fikjen e zjarrit, kutinë me paisje për dhënien e ndihmës së parë, ventilim të përhershëm si dhe të posedojë një higjienë – sanitare.

Neni 11.

Në lokalet – barnatoret bujqësore dhe depotë e dedikuara për tregtim të pesticideve rreptësisht ndalohet mbajtja dhe tregtimi i artikujve të tjerë, prodhimeve ushqimore për njerëz, kafshë, shpezë dhe prodhimeve të tjera të cilat nuk bëjnë pjesë në pesticide.

Neni 12.

Personi i licencuar për tregtim të pesticideve është i obliguar që vendosjen dhe ekspozimin e pesticideve ta bëjë në rafte dhe të njejtat duhet të jenë të radhitura sipas klasifikimeve, në paketim origjinal, të mbyllur dhe në kushtet e ruajtjes ashtu siç ipen sipas udhëzimeve të prodhuesit.

Pesticidet që kategorizohen si të rrezikshme duhet të vendosën në rafte të mbyllura me xham.

Personi i licencuar për tregtim të pesticideve nuk mund t'i shes, t'i shpërndajë ose në mënyrë tjetër t'a furnizojë me pesticide personin më të ri se 18 vjet.

Neni 13.

Personi i licencuar mund të importojë dhe tregtojë vetëm pesticide me afat të përdorimit – minimumi një (1) vit dhe të cilat janë me ambalazhim origjinal në të cilin ose mbrenda të cilit është i shkruar “Udhëzimi dhe Mënyra e Përdorimit të Pesticideve” në gjuhën e përdoruesit.

Neni 14.

Pesticidet me afat të skaduar të përdorimit nuk mund të tregtohen - shiten, dhe ato të cilave iu është dëmtuar ambalazhi, gjegjësisht kontejneri nuk mund të tregtohen - shiten, dhe se në raste të tilla duhet siguruar riambalazhimin e tyre me autorizimin të cilin do ta lëshojë Ministria.

Neni 15.

Personat që merren me importimin dhe tregtimin e pesticideve duhet që rregullisht të mbajnë librin e furnizimit dhe të shitjes së pesticideve që do të dizajnohet dhe përgatitet nga Ministria, libër ky që ipet me rastin e licencimit të importuesve dhe tregtuesve të pesticideve, në të kundërtën mungesa e librit të furnizimit dhe shitjes do të sanksionohet.

Neni 16.

Personat që merren me importimin dhe tregtimin e pesticideve duhet që në çdo kohë të dërgojnë listën e pesticideve që kanë në depo apo barnatore bujqësore në entet shëndetësore për të njohftuar për llojet e helmeve dhe këto ente do të veprojnë në raste të helmimeve më lehtë me kundërhelme –antidota. Këto lista duhet të përmbajnë emrin e materies aktive, kategorinë e helmit, emrin e preparatit dhe emri i antidotit që gjendet i shkruar në ambalazh të pesticidit.

Neni 17.

Moszbatimi i këtij Udhëzimi Administrativ, sanksionohet me ndëshkimet e përcaktuara me nenin 18 të Ligjit për Pesticide.

Neni 18.

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

_____ 2004

Ministri i Ministrisë së Bujqësisë,
Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural

/ Goran Bogdanoviq/